

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

JOHANA HAJDERLLI

KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Këshilltar për marrëdhëniet me publikun dhe mediat

e-mail:johana.hajderlli@yahoo.com

Orari i punës:Administrata e Qarkut

E hënë-E premte

8:00-16:00

Adresa:lagjia 7,rruga”28 Nëntori”

KOMPETENCAT

- AUTORITETI PUBLIK ËSHTË I DETYRUAR TË INFORMOJË KËRKUESIN NËSE KA OSE JO NË ZOTËRIM INFORMACIONIN E KËRKUAR.
- INFORMACIONI PUBLIK QË I ËSHTË DHËNË NJË PERSONI, NUK MUND T’I REFUZOHET ASNJË PERSONI TJETËR QË E KËRKON ATË, ME PËRJASHTIM TË RASTIT KUR INFORMACIONI PËRMBAN TË DHËNA PERSONALE TË SUBJEKTIT, NË PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË LIGJI NR. 119/2014 “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”.
- NË ÇDO RAST, KËRKESA REGJISTROHET NË REGJISTRIN E KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, TË PARASHIKUAR NË NENIN 8 TË KËTIJ LIGJI.
- NË ÇDO RAST, KËRKESA PËR INFORMIM REGJISTROHET DHE PËR TË ÇAKTOHET NJË NUMËR RENDOR. NUMRI RENDOR, SË BASHKU ME TË DHËNAT E KONTAKTIT TË KOORDINATORIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT, I JEPEN KËRKUESIT QË KA BËRË KËRKESËN PËR INFORMIM.
- KËRKESAT PËR INFORMIM REGJISTROHEN SIPAS RADHËS SË PARAQITJES DHE TRAJTOHEN PA DALLIME MES TYRE.
- NË QOFTË SE KËRKESA PËR INFORMIM NUK E PËRCAKTON FORMATIN NË TË CILIN KËRKOHET INFORMACIONI, AI JEPET NË MËNYRËN MË TË EFEKTSHME DHE ME KOSTON MË TË ULËT PËR AUTORITETIN PUBLIK.
- AUTORITETI PUBLIK BËN TË MUNDUR QË INFORMACIONI, I CILI I ËSHTË DHËNË TË PAKTËN NJË HERË NJË KËRKUESI, TË BËHET I DISPONUESHËM NË MËNYRËN MË PRAKTIKE TË MUNDSHME PËR TË GJITHË PERSONAT E TJERË QË MUND TA KËRKOJNË NË TË ARDHMEN.
- KËRKESAT PËR INFORMIM PËR INFORMACIONE TË REGJISTRUARA NË REGJISTRIN E KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PLOTËSOHEN JO MË VONË SE 3 DITË PUNE NGA MOMENTI I PARAQITJES SË KËRKESËS.

- AUTORITETI PUBLIK, JO MË VONË SE 6 MUAJ NGA HYRJA NË FUQI E KËTIJ LIGJI OSE NGA KRIJIMI I TIJ, VË NË ZBATIM NJË PROGRAM INSTITUCIONAL TË TRANSPARENCËS, KU PËRCAKTOHEN KATEGORITË E INFORMACIONIT QË BËHEN PUBLIKE PA KËRKESË DHE MËNYRAT E BËRJES PUBLIKE TË KËTIJ INFORMACIONI.
- AUTORITETI PUBLIK TRAJTON KËRKESËN PËR INFORMIM, DUKE PARASHTRUAR INFORMACIONIN E KËRKUAR SA MË SHPEJT QË TË JETË E MUNDUR, POR JO MË VONË SE 10 DITË PUNE NGA DITA E DORËZIMIT TË SAJ, PËRVEÇ RASTEVE KUR LIGJI I POSAÇËM PARASHIKON NDREYSHE.
- PËR ZBATIMIN E KËTIJ LIGJI, ME QËLLIM BASHKËRENDIMIN E PUNËS PËR GARANTIMIN E SË DREJTËS SË INFORMIMIT, AUTORITETI PUBLIK ÇAKTON NJË PREJ NËPUNËSVE SI KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT.
- MOSRESPEKTIMI I DISPOZITAVE TË LIGJIT NR. 119/2014 “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT” PASSJELL PËRGJEGJËSI ADMINISTRATIVE, SIPAS RASTEVE TË PARASHIKUARA NË PIKËN 2 TË NENIT NR. 18.